



Funded by  
the European Union

# DORACAK PËR TREGUESIT GJEOGRAFIK dhe EMËRTIMET E ORIGJINËS



**IPRproject**  
Intellectual Property Rights Project

A project implemented by:





<b>Pjesa e I-rë: Konceptet kyçe</b>	2
1. Çfarë janë treguesit gjeografik dhe emërtimet e origjinës?	2
2. Përse janë të dobishëm për biznesin tuaj treguesit gjeografik dhe emërtimet e origjinës?	4
3. Kohëzgjatja e treguesit gjeografik dhe emërtimit të origjinës	5
<b>Pjesa e II-të: Validiteti</b>	6
1. Kërkesat ligjore	6
2. Praktikrat më të mira për përdorimin e treguesve gjeografik dhe emërtimeve të origjinës	6
<b>Pjesa e III-të: Mbrojtja</b>	8
1. Mbrojtja e treguesve gjeografik dhe emërtimeve të origjinës në Kosovë	8
2. Mbrojtja e treguesve gjeografik dhe emërtimeve të origjinës jashtë vendit	10
<b>Pjesa e IV-të: Korniza ligjore</b>	11
1. Ligji	11
2. Legjislacioni sekondar	11
<b>Pjesa e V-të: Komercializimi dhe zbatimi i treguesve gjeografik dhe emërtimeve të origjinës</b>	11
1. Komercializimi i treguesve gjeografik dhe emërtimeve të origjinës	11
2. Shkeljet dhe mjetet juridike	12
<b>Pjesa e VI-të: Mjetet e fundit</b>	13
1. Marrja e ndihmës/ kontaktet	13
2. Faqet e dobishme të internetit	13

Qëllimi i këtij Doracaku:

Qëllimi i përgjithshëm i këtij Doracaku është të rrisë ndërgjegjësimin e bartësve të të drejtave dhe të popullatës në përgjithësi, për rëndësinë e Treguesve Gjeografik (në tekstin e mëtejshëm "TGJ") dhe Emërtimeve të Origjinës (në tekstin e mëtejshëm "EO"), për zhvillimin dhe rritjen e biznesit të tyre dhe të komunitetit.



# Pjesa e I-rë – Konceptet kyçe

## Çfarë janë treguesit gjeografik dhe emërtimet e origjinës?

Thënë më thjeshtë, një Tregues Gjeografik mund të kuptohet si një shenjë gjeografike që dallon produktet që vijnë nga një vend i caktuar gjeografik, ku cilësia, reputacioni i tyre apo karakteristikat e tjera të veçanta, janë si rezultat i faktit se ato vijnë nga ai vend gjeografik. Më konkretisht, neni 4.1.4 i Ligjit të Kosovës për TGJ dhe EO (Ligji Nr. 05 / L-051) përcakton “Treguesit Gjeografikë” si “ emrin e një rajoni, të një vendi specifik apo në raste të veçanta emri i një shteti, që përdoret për të përshkruar një produkt që ka origjinë nga ai rajoni, vend specifik ose shtet, [kur ai] zotëron një cilësi, reputacion apo karakteristika tjera specifike të cilat vijnë si rezultat i origjinës gjeografike, prodhimi dhe/ose përpunimi dhe/apo përgatitja e të cilit zhvillohet tërësisht në zonën e përcaktuar gjeografike;”.

Nga ana tjetër, “Emërtimi i origjinës” përcaktohet me nenin 4.1.3 si “ emri i një ra-



joni, të një vendi specifik apo në raste të veçanta, emri i një shteti, i cili përdoret për të përshkruar një produkt që ka origjinë nga ai rajon, vend specifik ose shtet, [kur] cilësitë ose karakteristikat e të cilit janë esencialisht ose ekskluzivisht si rezultat i një mjedisi gjeografik të veçantë me faktorët natyrorë dhe njerëzorë të trashëguar nga ky mjedis, dhe si rezultat i prodhimit, përpunimit dhe përgatitjes së produktit e cila zhvillohet tërësisht në zonën e përcaktuar gjeografike;”.

Emërtimet e regjistruara të origjinës ose të treguesve gjeografikë mund të përdoren nga çdo prodhues ose përpunues për të reklamuar produktet e tyre, kur ato janë në përputhje me specifikimet përkatëse të cilësisë, dhe prodhuesi / përpunuesi është anëtar i Regjistrit të Përdoruesve të Autorizuar (neni 14).



Nga përkufizimet e mësipërme, duhet të jenë të pranishëm tre elementë në mënyrë që të kualifikohen si TGJ dhe EO:

1. Termi duhet të jetë emri gjeografik (shpesh i një vendi / rajoni / zone).
2. Ai duhet të shërbejë për të emërtuar një produkt me origjinë nga ai vend / rajon / zonë.
3. Duhet të ketë një lidhje cilësore midis produktit dhe rajonit gjeografik.

Njësoj si dhe markat tregtare, TGJ dhe EO janë shenja dalluese. Megjithatë, ekzistojnë disa dallime të mëdha:

**A.** Pronësia: ndryshe nga markat tregtare, TGJ-të-EO-të nuk dallojnë produktet ose shërbimet e një ose më shumë ndërmarrjeve (personave fizikë ose ndërmarrjeve), por ato identifikojnë mallrat (dhe shumë rrallë edhe shërbimet) me origjinë nga një zonë e veçantë gjeografike: kjo do të thotë që të gjitha ndërmarrjet që veprojnë në atë zonë gjeografike, anëtarë të shoqatës përkatëse të prodhuesve/përpunuesve, dhe që përkohë me standardet përkatëse cilësore, kanë të drejtë të përdorin TGJ-EO.

**B.** Cilësia: ndryshe nga markat tregtare, TGJ-EO nënkuptojnë zbatimin e standardeve specifike cilësore. Këto mund të marrin formën e faktorëve natyrorë (p.sh.: tokës, ajrit, klimës, etj.) Dhe faktorëve njerëzorë (pra.: metodave të prodhimit ose përpunimit).



Probably the most famous example of GI is CHAMPAGNE. This GI can be used by all producers of white sparkling wine, established in the French region of Champagne, provided that they are members of the Champagne Association, and they comply with the required qualitative standards.

Mbase shembulli më i mirënjohur i TGJ-ve është SHAMPANJA. Ky TGJ mund të përdoret nga të gjithë prodhuesit e verës së bardhë me shkëlqim, të themeluar në rajonin francez të Champagne, me kusht që ata të jenë anëtarë të Shoqatës “Champagne”, dhe respektojnë standardet e kërkuara cilësore. Prodhuesit e përdorin TGJ-në së bashku me markat e tyre tregtare, të tilla si, CRYSTAL, MOET CHANDON, VEUVE CLIQUOT, etj. Ndërsa, prodhuesve të verës së bardhë me shkëlqim që janë të vendosur në vendet të tjera (madje edhe në pjesë të tjera të Francës) u ndalohet të përdorin termin SHAMPANJË në produktet e tyre.



### **GEOGRAPHICAL INDICATIONS and DESIGNATIONS OF ORIGIN**

do not protect:

- The name of a company.
- Inventions and innovative solutions.
- The ornamental shapes of products or packaging

Ashtu si të gjitha të drejtat e tjera të PI-së, edhe TGJ-të dhe EO-të rregullohen nga “parimi i territorialitetit”. Kjo do të thotë që ato gëzojnë mbrojtje në një shtet të caktuar vetëm nëse janë regjistruar dhe paraqitur siç duhet atje. Nëse nuk ndodh kështu, termi do të merret në konsideratë në domenin publik, dhe si i tillë, ai mund të përvetësohet ose kopjohet nga çdokush.

TGJ-të dhe EO-të nuk mund të mbrohen nga personat, por vetëm nga shoqatat e prodhuesve/tregtarëve/përpunuesve. Shoqatat e tilla duhet të mbështeten në ndihmën e ekspertëve.

Është e rëndësishme të sjellim në vëmendje se, siç u përmend më lart, TGJ-të dhe EO-të mbrojnë vetëm shenjat që dallojnë produktet që vijnë nga një vend i caktuar gjeografik, ku cilësia, reputacioni ose karakteristikat e tjera specifike, janë si rezultat i



faktit se ato vijnë nga ai vend gjeografik. Në anën tjetër, ato nuk mbrojnë:

- Emrat e ndërmarrjeve dhe bizneseve individuale: kjo duhet të mbrohet ndaras si markë tregtare (shih Doracakun për Markat Tregtare).
- Karakteristikat teknike të produkteve: të cilat duhet të mbrohen, nëse në ndonjë mënyrë, përmes patentave (shih Doracakun për Patentat).

## **Përse Treguesit Gjeografik dhe Emërtimet e Origjinës janë të dobishëm për biznesin tuaj?**

Në mjedisin afarist të ditëve të sotme, të karakterizuar nga një konkurrencë e ashpër në mbarë botën, një mjet jashtëzakonisht i fuqishëm i markës tregtare dhe faktor dallues përfaqësohet nga TGJ-të dhe EO-të. Ato mundësojnë që produktet tuaja të lartësohen në treg, të vërehen dhe të blihen nga klientët. Ato gjithashtu shpesh çojnë në çmime dhe sasi më të larta të shitjeve.

Funksionet kryesore të TGJ-së dhe EO janë:

- Të informojnë konsumatorët për origjinën e produkteve të caktuara (për të kuptuar që origjina e tillë gjeografike ka ndikim të drejtpërdrejtë në cilësinë dhe karakteristikat e produkteve); dhe
- Të ndalojnë përdorimin e tyre nga ndërmarrjet që nuk janë të vendosura në zonën gjeografike përkatëse dhe që nuk janë në përputhje me standardet e kërkuara cilësore.

TGJ-të dhe EO-të janë të drejtat e vetme të PI-së që ofrojnë informacion në lidhje me cilësinë (shpesh superiore) të produk-

tit të mbuluar nga shenja në fjalë. Me sa duket, TGJ /EO-të përfaqësojnë një faktor kyç që ndikon në zgjedhjen që bëjnë klientët, veçanërisht kur një vend i caktuar gjeografik lidhet me një imazh të cilësisë.

Treguesit e Mbrojtur Gjeografik dhe Emërtimet e Origjinës sjellin një avantazh themelor për biznesin tuaj: të drejta ekskluzive mbi atë term të veçantë gjeografik. Kjo në praktikë do të thotë që:

- vetëm shoqata e prodhuesve tuaj do të ketë të drejtë të përdorë një term të tillë gjeografik në vendin tuaj (ose në çdo vend ku ju paraqisni TGJ/EO-në) për të shitur llojin tuaj të produkteve.
- Shoqata juaj do të ketë të drejtë të parandalojë palët e treta, që nuk posedojnë autorizimin e saj, të prodhojnë apo shesin mallra që mbajnë Treguesin tuaj të mbrojtur Gjeografik.

Neni 12 i ligjit të Kosovës (dhe neni 24 i Udhëzimit Administrativ) parasheh që emërtimet e origjinës apo treguesit gjeografik të regjistruar mbrohen ndaj:



- **a.** çdo përdorimi direkt apo indirekt në tregti të produkteve të cilat nuk janë regjistruara për atë kohë sa këto produkte janë të krahasueshme me produktet e regjistruara nën emërtimin e origjinës, apo për atë kohë sa përdorimi i emërtimit të origjinës apo treguesit gjeografik shfrytëzon reputacionin e emërtimit të origjinës apo treguesit gjeografik të mbrojtur;
  - **b.** çdo keqpërdorimi, imitimi apo evokimi, edhe po që se shënohet origjina e vërtet e produktit apo nëse emri i emërtimit të origjinës apo treguesi gjeografik është i përkthyer apo i transliteruar apo është shoqëruar shprehje të tillë si “stil”, “lloj”, “metodë”, “si prodhohet në”, “imitim”, apo të tjera të ngjashme me to;
  - **c.** çdo treguesi të pasaktë apo çorientues për sa i përket prejardhjes, origjinës, natyrës apo cilësive thelbësore të produktit, në paketimin e brendshëm apo të jashtëm, në materialet e reklamimit apo dokumentet për produktin, dhe paketimi i produktit në kontejner që ka prirje të jap përshtypje të gabuar për sa i përket origjinës;
- Ashtu si dhe të drejtat e tjera të PI-së, të drejtat e Treguesve Gjeografik dhe Emërtuesve të Origjinës, për nga lloji janë të drejta territoriale. Kjo nënkupton që,

nëse planifikoni të eksportoni në një vend të ri produktet tuaja që mbajnë termin tuaj të vlefshëm gjeografik, sigurohuni që t'i mbronni ato paraprakisht dhe të jeni në harmoni me të gjitha kërkesat e parashikuara me ligjin e vendit në fjalë. Me fjalë të tjera, Treguesit Gjeografik dhe Emërtimet e Origjinës të regjistruara në Kosovë, nuk do të kanë mbrojtje në vendet e tjera, përveç nëse janë regjistruar siç duhet atje. Ky është i ashtuquajturi “parimi i territorialitetit”.

Në secilin vend, treguesit tuaj gjeografik do të mbrohen nga ligji i vendit dhe do të trajtohen, për të gjitha synimet dhe qëllimet, si e drejtë kombëtare (me fjalë të tjera, nuk do të jetë i mundur asnjë lloj diskriminimi vetëm se jeni i huaj).

Një përparësi tjetër është se nëse dorëzohet/paraqitet marka tregtare pas aplikimit të TGJ / EO-së për të njëjtin lloj malli, marka tregtare do të refuzohet (neni 13).

Anasjelltas, sigurohuni që të mos përdorni një term gjeografik të mbrojtur si Tregues Gjeografik ose Emërtim i Origjinës në vendin tuaj, nga shoqata e prodhuesve të tjerë, përndryshe ju do të shkelni të drejtat e saj ekskluzive dhe mund paditeni në gjyq dhe të gjobiteni: kujdes!

**BËNI KUJDES** të mos shkelni  
Treguesit Gjeografik të konkurrentëve tuaj!

Për ta përmbledhur, ju duhet të shikoni se cilët janë TGJ-të ekzistues në vendin tuaj, dhe nëse ndodh të prodhoni produktet tuaja saktësisht në zonën gjeografike të referuar nga një TGJ, dhe jeni në përputhje me standardet e kërkuara cilësore, kjo do të thotë që ju do të keni të drejtë për të përdorur TGJ-në në fjalë. Ky mund të jetë një mjet i rëndësishëm për të nxitur suksesin tuaj tregtar.

## Kohëzgjatja e të drejtave të treguesve gjeografik

Siç përcaktohet me nenin 15 të ligjit të Kosovës për Treguesit Gjeografik, Treguesit Gjeografik mbrohen për një periudhë prej 10 vjetësh nga data e regjistrimit. Kjo kohëzgjatje mund të rinovohet vazhdimisht deri në një afat të pacaktuar, nga 10 vjet.

Nëse tarifat e rinovimit nuk paguhen në fund të çdo periudhe 10-vjeçare, Treguesi Gjeografik do të bjerë në domenin publik në fund të periudhës së fundit për të cilën ishte mbrojtur.

## Pjesa e II-të:

# Vlefshmëria e treguesve gjeografik

**N**ë mënyrë që të mbrohet në Kosovë, treguesi gjeografik duhet të dorëzohet dhe regjistrohet në Agjencinë e Pronësisë Industriale të Kosovës (API). Treguesit gjeografik do të regjistrohen vetëm nëse ata janë në përputhje me kërkesat ligjore të parapara me ligjin për Treguesit Gjeografik (dhe veçanërisht nenin 9 të këtij ligji) dhe që përshkruhen më poshtë.

## Kërkesat ligjore për vlefshmërinë e një treguesi gjeografik dhe emërtimi të origjinës në Kosovë

Një emër nuk mund të regjistrohet si emërtim i origjinës apo tregues gjeografik nëse:

- është emër gjenerik;
- bie në konflikt me emrin e një varieteti bimor apo race shtazore dhe si rezultat do





- të mashtronte konsumatorin për origjinën e vërtetë të produktit;
- tregon apo sugjeron se produkti ka prejardhje nga një zonë tjetër gjeografike dhe jo nga vendi i saktë i prejardhjes i cili e çorienton apo keqinformon publikun lidhur me origjinën gjeografike të produktit;
- krijon konfuzion në treg në lidhje me llojin, origjinën, kualitetin, mënyrën e prodhimit ose karakteristikat tjera të produktit;
- është në kundërshtim me rendin apo moralin publik;
- në lidhje me reputacionin, njohjen e markës tregtare dhe të periudhës kohore të përdorimit të saj, regjistrimi besohet se do ta çorientojë konsumatorin sikur të jetë identiteti i vërtetë i produktit;
- është plotësisht ose pjesërisht homonim me një emër tashmë të regjistruar në Regjistrin e emërtimeve të mbrojtura të origjinës dhe treguesve gjeografikë. Një emër homonim që çorienton konsumatorin për të besuar se produktet vijnë nga një territor tjetër nuk duhet të regjistrohet (neni 10).

Nëse termat e propozuar përputhen me përkufizimin e TGJ ose EO-së (siç parashihet me nenin 4), nuk bien nën ndalesat e mësipërme (të përcaktuara me nenin 9) dhe janë në përputhje me kërkesat e tjera të përcaktuara me ligj, ato do të regjistrohen dhe do të ju lëshohet një certifikatë. Urime!

## **Praktikat më të mira për përdorimin e treguesve gjeografik dhe emërtimeve të origjinës**

Ekzistojnë disa praktika më të mira që përdoruesit duhet të kenë parasysh në fushën e Treguesve Gjeografik dhe Emërtimeve të Origjinës. Këto përfshijnë:

1. Simboli dhe fjala përkatëse e TGJ/EO-së duhet të përdoret gjithmonë në produktet përkatëse saktësisht në modalitetet e parashikuara nga Libri i Specifikimeve. Ky nuk është vetëm një mesazh i mirë paralajmërues për shkelësit e mundshëm, por edhe një mjet jashtëzakonisht i fuqishëm i promovimit të markës tregtare/produktit.
2. Në veçanti, çdo produkt me origjinë nga Kosova që tregtohet sipas emërimit të origjinës ose treguesit gjeografik, në përputhje me ligjin vendor, duhet të etiketohet me shënimin “emërtim i mbrojtur i origjinës” dhe “tregues i mbrojtur gjeografik” ose me simbole që i shoqërojnë ato.



3. Është thelbësore që standardet e cilësisë të mirëmbahen dhe të zbatohen vazhdimisht nga të gjithë anëtarët e shoqatave. Nëse kjo nuk ndodh, klientët do të humbasin besimin te TGJ / EO-të dhe do të ndalojnë së perceptuari atë si një mjet i sigurimit të cilësisë. Kjo nënkupton që çdo shoqatë që dëshiron të regjistrojë një TGJ / EO-të duhet të krijojë mekanizma shumë rigorozë të monitorimit të cilësisë dhe të sigurojë zbatimin e rreptë të tyre.
4. Pronarët e Treguesve Gjeografik duhet të monitorojnë vazhdimisht tregun për të siguruar që askush të mos kopjojë ose keqpërdorë shenjat e tyre të mbrojtura.
5. Një emërtim i origjinës ose tregues gjeografik i regjistruar mund të përdoret në tregti dhe në reklamë vetëm nga prodhuesit ose përpunuesit që janë anëtarë të shoqatës përkatëse si Përdorues të Autorizuar, dhe vetëm nëse produktet e tyre janë në harmoni me specifikimet përkatëse.
6. Në fund, anëtarët e ndryshëm të shoqatës së TGJ / EO-ve duhet të përdorin gjithashtu markat e tyre individuale tregtare për të dalluar produktet e tyre nga ato të anëtarëve të tjerë të së njëjtës shoqatë. Për shembull, derisa të gjithë anëtarët e shoqatës Champagne mund të përdorin termin “Champagne” në verën e tyre të bardhë me shkëlqim, secili prodhues do të përdorë edhe markën e vet tregtare (p.sh.: Veuve Clicquot; Moët Chandon, etj.)



Geographic Indication



## Pjesa e III-të: Mbrojtja

Sfida kryesore për sigurimin e mbrojtjes së TGJ-ve dhe EO-ve është se marrëveshjet ndërkombëtare nuk përcaktojnë një mënyrë unike se si ata duhet të mbrohen. Ekzistojnë katër regjime të mundshme që janë miratuar nga vende të ndryshme për të mbrojtur TGJ/EO-të:

- konkurrenca e pandershme (ose kalimi)
- mbrojtja e konsumatorit (p.sh. : etiketimi i verës)
- shenjat kolektive dhe të çertifikimit (shih Doracakun për Markat Tregtare)
- Mbrojtja Sui Generis (pra.: një ligj që parashikon posaçërisht mbrojtjen e TGJ-ve, si në rastin e Kosovës).

Kosova, në një linjë me shumë vende të tjera, ndjek qasjen e fundit. Megjithatë, nëse dëshironi të eksportoni produktet tuaja, të mbuluara nga TGJ/EO lokale, në një vend



tjetër, atëherë duhet të siguroheni që edhe ai vend të njohë TGJ/EO-në tuaj. Kjo është një çështje e ndërlikuar. Disa qeveri kanë nënshkruar marrëveshje bilaterale ose rajonale me shtetet e tjera për njohjen reciproke të TGJ/EO-ve përkatëse.

Gjithashtu ekziston një marrëveshje ndërkombëtare që lehtëson regjistrimin ndërkombëtar të emërtimeve të origjinës (lloje të veçanta të TGJ-ve): Marrëveshja e Lisbonës. Ajo funksionon në një mënyrë shumë të ngjashme me sistemin e Madridit dhe sistemin e Hagës, dhe lejon sigurimin e mbrojtjes në cilindo nga 35 vendet palë në sistem. Hëpërhë, lajmi i keq nuk është vetëm se 35 është një numër shumë i kufizuar, por edhe se Kosova nuk është anëtare e sistemit të Lisbonës dhe për këtë arsye ju nuk do të jeni në gjendje të përdorni këtë strukturë.

Agjencia e Pronësisë Industriale është përgjegjëse për procedurën e regjistrimit të emërtimeve të origjinës dhe treguesve gjeografik (neni 6).

Siç përmendet në Pjesën e I-rë, Paragrafin 1 të këtij Doracak, përdoruesit duhet të mbrojnë TGJ/EO-të e tyre në të gjitha vendet ku ata bëjnë ose synojnë të bëjnë biznes. Kjo për shkak se të drejtat e pronësisë intelektuale, përfshirë indikacionet gjeografike, janë të natyrës territoriale (në bazë të Parimit të TERRITORIALITETIT). Kjo do të thotë që hyrja në një vend të ri pa dorëzuar siç duhet Treguesit Gjeografik mund të jetë shumë e rrezikshme: shenjat e tyre mund të kopjohen, dhe pronarët e tyre legjitimë mund të mos jenë në gjendje të bëjnë shumë për të zbatuar të drejtat e tyre.



## Mbrojtja e treguesve gjeografik në Kosovë

Për të siguruar mbrojtje për një tregues gjeografik në Kosovë, duhet të depozitohet një aplikacion në zyrën kombëtare të PI-së, e quajtur Agjencia për Pronësi Industriale në Kosovë (API). Ju lutemi vizitoni faqen e mëposhtme të internetit për të marrë informacion në lidhje me formularin që duhet të përdorni, tarifat që duhet të paguani dhe procedurën që duhet të ndiqni:

KIPA (rks-gov.net)

Aplikacioni për regjistrimin e një emërtimi të origjinës ose treguesi gjeografik mund të mbulojë vetëm një emërtim / tregues që duhet të shoqërohet vetëm me një lloj të produkteve (neni 21).

Vetëm subjektet e mëposhtme kanë të drejtë të paraqesin aplikacion për TGJ/EO:

- çdo shoqatë e prodhuesve apo përpunuesve që punojnë më të njëjtin produkt, pa marrë parasysh përbërjen apo formën e saj ligjore;
- një person i vetëm fizik apo juridik me kusht që të paraqitet në kohën e plotësimit të aplikacionit për regjistrim, se personi në fjalë është i vetmi prodhues në zonën e përcaktuar gjeografike i gatshëm të dorëzojë një aplikacion dhe se zona e përcaktuar gjeografike posedon karakteristika të cilat dukshëm ndryshojnë nga ato të zonave fqinje apo karakteristikat e produktit janë të ndryshme prej atyre që prodhohen në zonat fqinje;

Aplikacioni për regjistrim duhet të përmbajë (neni 23):

emrin dhe adresën e çdo shoqate të prodhuesve apo përpunuesve që aplikon të shoqëruar me informata për statusin ligjor dhe përbërjen, nëse aplikacioni plotësohet nga një shoqatë e prodhuesve apo përpunuesve;

- emrin dhe adresën e personit që aplikon të shoqëruar me prova adekuate për statusin ligjor, nëse aplikacioni plotësohet nga një person i vetëm;
- emri i emërtimit të origjinës apo të treguesit gjeografik;
- përshkrimin e produktit (që duhet të përfshijë të dhëna të hollësishme teknike që përdoren zakonisht për të përshkruar llojin e produktit, përfshirë karakteristikat ndijore - organoleptike. Ai mund të përfshijë gjithashtu, kur shihet si e përshtatshme, rregulla specifike lidhur me paketimin dhe etiketimin);
- përcaktimin e zonës gjeografike (që duhet të përcaktohet në mënyrë të detajuar dhe

precize, që të mos ketë paqartësi dhe të vendosë konturat në lidhje me marrëdhëni-  
et midis cilësisë ose karakteristikave të produktit dhe mjedisit të tij gjeografik);

- specifikacionet e produktit;
- përshkrimin e lidhjes në mes produktit dhe origjinës gjeografike të tij (duke sqaruar sesi karakteristikat e zonës së përcaktuar gjeografike ndikojnë produktin final);
- dëshminë mbi pagesat e kryera të tarifave e përcaktuara;
- autorizimin nëse personi që aplikon përfaqësohet nga përfaqësuesi i autorizuar;
- dëshmi mbi mbrojtjen e emërimit të origjinës apo treguesit gjeografik në vendin e tij, në formë të kopjes së një certifikate apo dokumenti tjetër ligjor në gjuhën zyrtare të vendit të origjinës me përkthim të dokumentit, nëse emri i origjinës apo treguesi gjeografik ka të bëjë me një zonë gjeografike të vendosur jashtë Kosovës.

Gjithashtu, duhet të ketë metoda për verifikimin e pajtueshmërisë me standardet cilësore që parashihen në Librin e Specifikimeve. Një verifikim i tillë duhet të kryhet nga autoritetet ose organet duhet të jenë institucione të autorizuar, dhe të njohura për verifikimin e pajtueshmërisë së produktit me dispozitat e specifikimit. Në rastin e produkteve bujqësore ose ushqimore, organet e verifikimit duhet të miratohen nga Ministria e Bujqësisë.

Pas shqyrtimit të tij, aplikacioni publikohet me qëllim të apelimit. Nëse nuk paraqitet asnjë ankesë brenda tre muajve nga data e publikimit, TGJ/EO-ja regjistrohet dhe krijohet një certifikatë.

Neni 44 përcakton procedurën e regjistrimit të një përdoruesi të autorizuar të një emër-  
timi të mbrojtur të origjinës ose një treguesi të mbrojtur gjeografik. Në këtë kontekst,  
pas regjistrimit të emërimit përkatës të origjinës ose treguesit gjeografik, një aplikacion  
për regjistrim të përdoruesit të autorizuar mund të paraqitet në API nga çdo prodhues  
ose përpunues (person fizik ose juridik) që prodhon ose përpunon produktin e mbrojt-  
tur nga emërtimi i origjinës ose treguesi gjeografik, në përputhje me specifikimet për-  
katëse cilësore të produktit.

Procedura e regjistrimit rregullohet nga Udhëzimi Administrativ (MTI) NR. 11/2016 për  
Regjistrimin e Treguesit Gjeografik. Ky përshkrim legjislativ në nenin 5 dhe 6 përmban  
të dhëna më të hollësishme rreth asaj se çfarë duhet të përmbajë aplikacioni i treguesit  
gjeografik.



Neni 11 përcakton që nëse emërtimi i origjinës ose treguesi gjeografik lidhet me zonat gjeografike jashtë Kosovës, mbrojtja do të jepet nëse aplikimi përputhet me kriteret e përcaktuara në ligj, dhe nëse emërtimi në fjalë mbrohet në vendin e origjinës. Për më tepër, një emërtim nuk mund të regjistrohet si një emërtim i origjinës ose tregues gjeografik kur ai nuk ishte i mbrojtur ose nuk mbrohet në vazhdimësi ose nuk përdoret në vendin e origjinës.

Nëse paraqitësja e aplikimit është shoqatë e huaj, aplikimi duhet të bëhet nga një përfaqësues vendas, përmes një prokure.

Kur aplikimit të jetë dorëzuar në API, ekzaminuesit do të kontrollojnë pajtueshmërinë me të gjitha kërkesat zyrtare dhe e njoftojnë aplikuesin në rast se identifikohen parregullsi.

## Mbrojtja e treguesve gjeografik jashtë vendit

Nëse shoqata që ka në pronësi një TGJ/EO në Kosovë dëshiron të eksportojë produktet e mbuluara nga TGJ/EO e tillë, në vendet e tjera, duhet të kërkojë mbrojtje për TGJ/EO e tillë në ato vende, duke paraqitur kërkesa në të gjitha vendet me interes. Siç u përmend më lart, ky proces nuk është i lehtë, dhe neni 11.3 dhe 4 e përcaktojnë që mbrojtja e emërtimit të origjinës apo e treguesit gjeografik mund të ofrohet gjithashtu në bazë të marrëveshjeve bilaterale ose ndërkombëtare për mbrojtjen reciproke të TGJ/EO-ve, ku Republika e Kosovës është anëtare. Në këtë rast, fushëveprimi i mbrojtjes së këtyre emërtimeve të origjinës ose treguesve gjeografikë do të jetë i njëjtë me mbrojtjen e ofruar për emërtimet e origjinës ose treguesit gjeografik sipas Ligjit vendor (përveç nëse marrëveshja përkatëse bilaterale ose ndërkombëtare e përcakton ndryshe).

Nga ana tjetër, ekziston një zgjidhje që mund të dëshmohet si e dobishme dhe më e lirë: **Sistemi i Lisbonës për Regjistrimin Ndërkombëtar të Treguesve Gjeografik.** Sistemi i Lisbonës është një procedurë e thjeshtë, më e lirë, efektive, e centralizuar, e administruar nga WIPO; ndalesa e vetme për pronarët e treguesve gjeografik, që të kërkojnë mbrojtje në tregjet e shumta të eksportit. Sistemi i Lisbonës i mundëson bartësve të treguesve gjeografik të marrin mbrojtje duke paraqitur një kërkesë të vetme, në një gjuhë (përfshirë anglishten), me tarifa në një monedhë (franga zvicerane) deri në 35 vende, pa pasur nevojë të angazhojnë një agjent lokal të PI-së në të gjitha këto vende.





Fatkeqësisht, sistemi i Lisbonës është një sistem “i mbyllur”: ai mund të përdoret vetëm nga shoqata, konsorciume, etj. që:

1. Janë shtetas të një prej vendeve të Unionit të Lisbonës; ose
2. Kanë vendbanimin e përhershëm ose vendqëndrimin në një nga ato vende; ose
3. Posedojnë ndërmarrje tregtare ose industriale të vërtetë dhe efektive në njërin nga vendet anëtare të Unionit të Lisbonës.

Siç u përmend, Kosova nuk është anëtare e sistemit të Lisbonës. Kjo do të thotë që, për fat të keq, tani për tani për këtë arsye, kjo nuk mund të përdoret nga shoqatat kosovare.

Informacioni për Lisbonën mund të gjendet në: Lisbon - The International System of Geographical Indications ([wipo.int](http://wipo.int))

## **Pjesa e IV-të: Korniza ligjore**

### 1. Ligji:

- Ligji për Treguesit Gjeografik dhe Emërtimet e Origjinës, nr. 05 / L-051

### 2. Legjislativi i përzgjedhur sekondar:

- Udhëzimi Administrativ (MTI) nr. 11/2016 për Treguesit Gjeografik dhe Emërtimet e Origjinës;
- Udhëzimi Administrativ MTI-10/2016 për Tarifat Administrative për Objektet e Pronësisë Industriale, 6

# **Pjesa e V-të- Komericializimi dhe zbatimi i treguesve gjeografik dhe emërtimeve të origjinës**

## **Komericializimi i treguesve gjeografik dhe emërtimeve të origjinës**

Të kesh një TGJ/EO të regjistruar dhe të mos e shfrytëzosh atë në aspektin komercial do të ishte një vendim shumë i keq tregtar: është sikur të kesh një thesar dhe të mos e shfrytëzosh atë. Në të vërtetë, përdorimi i TGJ/EO-ve mund të bëhet një biznes shumë fitimprurës. Vetëm vendosja në etiketë ose në paketimin e produkteve tuaja, të shenjës “TMGJ - Tregues i Mbrojtur Gjeografik” ose “EMO - Emërtim i Mbrojtur i Origjinës “ dhe logos zyrtare dhe emrit të shoqatës, mund të rris ndjeshëm shitjet tuaja dhe çmimin me të cilin ju mund të shisni produktet tuaja. Statistikat botërore flasin qartazi në këtë drejtim.

Për shembull, të jesh në gjendje të shkruash në një shishë vere të bardhë me shkëlqim, termin “Champagne” jo vetëm që garanton vëllime më të larta të shitjes, por edhe një ekstra çmim, që nuk është i disponueshëm për verërat e tjera të bardha me shkëlqim, që nuk mbulohen nga TGJ të tilla.





Një shembull tjetër interesant përfaqësohet nga Kampot Pepper. Pas regjistrimit të tij si TGJ në vitin 2010 në Kamboxhia dhe në vitin 2016 në BE, Vietnam, etj., çmimi i shitjes së specit Kampot shkoi nga 8.9 dollarë amerikanë (për specin e zi), 15 dollarë amerikanë (për specin e kuq) dhe 17,7 dollarë amerikanë (për specin e bardhë) përkatësisht në 15 USD, 25 USD dhe 28 USD. Nga ana tjetër, çmimi i specit të zakonshëm, pa -TGJ të mbrojtur, u ul nga mesatarja 9.5 USD në 2015 në 2 USD në 2020. Në mënyrë të ngjashme, sasi të specit Kampot të shitur shkuan nga afërsisht 24.4 tonë në vit në 55.6 tonë në vit. Duhet gjithashtu të theksohet se rreth 70% e specit Kampot destinohet për tregun ndërkombëtar.



Ngjashëm me rastin e mësipërm, në BE, Franca dhe Italia shfrytëzuan jashtëzakonisht me sukses TGJ-të e tyre të regjistruara për verërat, ku shitjet e verërave të mbrojtura me TGJ në vitin 2017 shkuan në mbi 10 miliardë euro. Në Gjermani dhe Spanjë, vlerat silleshin nga 5 deri në 10 miliardë euro; dhe në Portugali, Holandë, Austri dhe Greqi, nga 1 miliard deri 5 miliardë euro. Në vitin 2017, eksportet (tregtia brenda BE-së dhe eksportet në vendet jashtë BE-së) arritën në 31.42 miliardë Euro (41% e vlerës totale të shitjeve).



Gjithashtu industria e birrës në BE përfitoi ndjeshëm nga TGJ-të: pesë shtete anëtare të BE-së aktualisht prodhojnë birra me TGJ, ku Gjermania dhe Republika Çeke e udhëheqin këtë treg. Në vitin 2017, vëllimi i shitjeve të birrave të mbuluara nga TGJ vlerësohej të arrinte 41.81 milion hl dhe vlera e shitjeve ishte 3.33 miliardë Euro nga një total prej 20 TGJ të regjistruara. Vlera e shitjes së birrës është rritur me 18% që nga viti 2010 dhe birrat me TMGJ kontribuan pothuajse tërësisht në këtë rritje.



## Shkeljet dhe mjetet juridike

Kjo pjesë përmban sugjerime praktike në rast se vije deri te kopjimi, cenimi apo shkelja nga palët e treta, të treguesve gjeografik ose emërtimeve të origjinës, brenda ose jashtë vendit, qoftë përmes mirëbesimit apo mashtrimit.

Së pari, shoqatat që zotërojnë TGJ/EO-të dhe anëtarët e tyre, duhet të veprojnë si monitorues dhe të monitorojnë vazhdimisht shkeljet e mundshme të shenjave të tyre nga palët e treta. Gjatë punës së tyre të përditshme, ata shpesh janë informuar për atë që bëjnë konkurrentët dhe për ndonjë shkelje të mundshme të TGJ/EO-ve të tyre.

Inicimi i procedurës gjyqësore duhet të lihet si mundësia e fundit, pasi ajo mund të zgjas shumë dhe me kohë rezultati i tij është i paparashikueshëm. Një letër e thjeshtë “pusho dhe heq dorë” mbase është e mjaftueshme për t’i dhënë fund një shkeljeje. Nëse kjo nuk çon në një zgjidhje të aktivitetit shkelës, pronarët e TGJ/EO-ve mund të përpiqen të arrijnë një zgjidhje jashtë gjykatës, përmes negociatave. Nëse edhe kjo përpjekje dështon, ato mund t’i kthehen shërbimeve të një ndërmjetësi profesional, i cili mund të lehtësojë arritjen e një marrëveshje të kënaqshme për të dy palët. Një sistem ADR veçanërisht i përshtatshëm për PI-të administrohet nga WIPO. Për më shumë informacion, ju lutemi referojuni uebfaqes vijuese: <http://www.wipo.int/amc/en/>

Në fund, në disa raste, proceset gjyqësore mbeten opsioni i vetëm në dispozicion për të arritur drejtësinë, me që rast ngritët padia në gjykatën kompetente (që zakonisht është Gjykata Themelore në Prishtinë).

Qartazi, vetëm avokatët me më përvojë duhet të ndërmarrin hapat e mësipërm.

Neni 64 përcakton që personat që kanë të drejtë të kërkojnë zbatimin e TGJ-ve dhe EO-ve të regjistruara përfshijnë grupin apo një person të vetëm që ka paraqitur kërkesë për regjistrim, ose çdo përdorues të autorizuar ose grup përdoruesish të autorizuar, ose çdo person të autorizuar nga ndonjëri nga ta, në përputhje me dispozitat e përgjithshme për përfaqësim, apo një prokuror të shtetit.

Mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit për TGJ-të dhe EO-të bëhet nga inspektorati përkatës në territorin e Kosovës (neni 76).

Sa i përket mjeteve juridike, korniza ligjore e Kosovës (Kapitulli i VI-të i Ligjit për Treguesit Gjeografik) përcakton mjetet juridike civile të mëposhtme për të zbatuar të drejtat e TGJ/EO-ve:

1. Kërkimi i konstatimit dhe ndalimit të shkeljes së TGJ-së dhe EO-së dhe të drejtave të tjera të ngjashme në të ardhmen (neni 65).
2. Kërkesa për konfiskimin dhe shkatërrim të produkteve (neni 66).
3. Kërkesa për kompensim të dëmit (neni 67).
4. Publikimi i vendimit të gjykatës që konfirmon shkeljen e treguesit gjeografik (neni 68).
5. Kërkimi i informacionit mbi origjinën dhe rrjetin e shpërndarjes së produkteve që shkelin treguesin gjeografik ose emrin e origjinës (neni 69).
6. Kërkimi i masave të përkohshme për të ndaluar ose parandaluar shkeljet, për të urdhëruar konfiskimin ose heqjen e produkteve të cilat janë në kundërshtim me ligjin, nga tregu ose për të ruajtur dëshmitë (neni 70 dhe 71).
7. Masat ndëshkuese, në formën e gjobave (neni 75).

Në anën tjetër, siç u përmend tashmë, biznesmenët kosovarë duhet të jenë jashtëzakonisht të kujdesshëm për të mos shkelur treguesit gjeografikë ose emërtimet e origjinës që janë të regjistruara dhe mbrohen në Kosovë (dhe në çdo vend tjetër ku ata bëjnë biznes), përndryshe kundër tyre mund të aplikohen të gjitha masat dhe sanksionet e mësipërme.



# Pjesa e VI-të: Mjetet e fundit

## Marrja e ndihmës / kontaktet

Agjencia e Pronësisë Industriale, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë  
Rr. "Muharrem Fejza", p.n, Lagjja e Spitalit, 10000- Prishtinë, Kosovë  
Telefon: +381 38 200 36554  
Email:

## Ueb faqe të dobishme

- Agjencia për Pronësi Industriale e Kosovës: [kipa.rks-gov.net](http://kipa.rks-gov.net)
- EUIPO: EUIPO - Home ([europa.eu](http://europa.eu))
- EPO: <http://www.epo.org/>
- FAO: [www.fao.org](http://www.fao.org)
- WIPO: [www.wipo.int](http://www.wipo.int)
- WIPO SME Division: [www.wipo.int/sme](http://www.wipo.int/sme)
- WIPO Arbitration and Mediation Center: <http://arbitr.wipo.int>
- WTO: <http://www.wto.org>
- EU: Geographical indications - Trade - European Commission ([europa.eu](http://europa.eu))
- OriTGJn - Home - [oritgjn | Organization for an International Geographical Indications Network \(oritgjn-tgj.com\)](http://oritgjn-tgj.com)
- Directory of IP Offices worldwide: <http://www.wipo.int/directory/en/urls.jsp>
- International Geographical Indication Association (INTA): <http://www.inta.org>
- IP Panorama: <https://www.wipo.int/sme/en/multimedia/>



Kjo broshurë është botuar me asistencë të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e kësaj broshure është përgjegjësi e vetme e IBF International Consulting dhe EPLO dhe në asnjë mënyrë nuk mund të paraqes pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

© IPR Project Kosovo  
Qershor, 2020  
Prishtinë, Kosovë

# IPRproject

Intellectual Property Rights Project

Rr. "Johan V. Hahn",  
10000 Prishtinë, Kosovë  
Tel: 038 726 688

 IPRKosovo